

Vendim nr. 209 datë 29.07.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 29.07.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 12 (M) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MIRAND ÇAUSHI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-609, datë 12.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 18, 33, 42, 43, 44, 131 pika 1, shkronja “f”, dhe 134 shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është një nga trashëgimtarët e babait të tij Xh.Ç. Këtij të fundit (trashëgimtarëve) dhe motrës së tij M.Ç.(P.), me vendimin nr. 103/2, datë 27.11.1993 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, Elbasan, u është njohur dhe kthyer në natyrë një banesë 2-katëshe, me sipërfaqe ndërtimore 104 m² dhe oborr 48 m², e ndodhur në qytetin e Elbasanit. Për këtë pasuri, sipas një aktmarrëveshjeje të datës 06.12.1994, trashëgimtarët e Xh.Ç. dhe shtetasja M.Ç.(P.), si bashkëpronarë të pasurisë, kanë bërë ndarjen vullnetare të saj. Pas kësaj, shtetasja M.Ç.(P.), atë pjesë të banesës dhe të oborrit, lënë asaj në pronësi, me kontratën e datës 17.05.1995, ia ka shitur shtetasit P.P., nipit të bashkëshortit të saj.

2. Mbi një padi të trashëgimtarëve të Xh.Ç., me vendimin nr. 1153, datë 02.11.1999, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka deklaruar të pavlefshme aktmarrëveshjen për ndarjen vullnetare të pasurisë, duke urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme me arsyen se ajo është e falsifikuar.

3. Po për një padi të trashëgimtarëve të Xh.Ç., me vendimin nr. 1368, datë 21.11.2001, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka deklaruar absolutisht të pavlefshme edhe kontratën e shitjes së datës 17.05.1995 të lidhur mes shtetasës M.Ç.(P.) dhe shtetasit P.P., duke urdhëruar kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 123, datë 04.03.2002, me plotësimin që shtetasi P.P., t'i lirojë banesën e blerë shtetasës M.Ç.(P.), pasi kjo e fundit t'i ketë kthyer çmimin e shitjes (5.000.000 lekë), duke llogaritur indeksin e zhvleftësimit të lekut në momentin e ekzekutimit të vendimit. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 942, datë 05.05.2004, ka vendosur mospranimin e rekursit të shtetasit P.P. Vendimi gjyqësor në këtë rast është regjistruar në regjistrat e hipotekës.

4. Në vijim, trashëgimtarët e Xh.Ç. kanë kërkuar gjyqësisht pjesëtimin e pasurisë. Në rigjykimin e çështjes, me vendimin nr. 1132, datë 14.07.2003, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur dhënien fund të bashkëpronësisë mes palëve ndërgjyqëse dhe e ka ndarë në natyrë pasurinë mes trashëgimtarëve të Xh.Ç. dhe shtetasës M.Ç.(P.), duke përcaktuar pjesët përkatëse të banesës dhe të oborrit të saj për secilën palë ndërgjyqëse. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 43, datë 10.02.2004.

5. Ndërkohë, me kontratën noteriale të shitjes, datë 28.02.2003, kërkuesi dhe bashkëpronarët e tjerë u kanë shitur pasurinë e tyre (atë pjesë të banesës dhe oborrit të saj të lënë atyre në pronësi) shtetasve A.Ç. dhe F.Ç. Po kështu, me deklaratën noteriale të datës 18.05.2004, ata kanë deklaruar dakordësinë e tyre që pasuria nr. 11/263, zona kadastrale 8522, për të cilën

bënte fjalë vendimi i formës së prerë nr. 1132, datë 14.04.2003 i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, të regjistrohet në emër të shtetasit A.Ç., pasi këtë pronë ia kanë shitur atij me kontratën noteriale të lartpërmendur, duke saktësuar sipërfaqen e truallit nën banesë dhe të oborrit (pjesën përkatëse të saj). Në vijim, kjo pronë është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Elbasan (ZRPP) në favor të blerësve A.Ç. dhe F.Ç.

6. Në datën 03.06.2009 shtetasja M.Ç.(P.) ka ndërruar jetë. Pas vdekjes së saj, mbi kërkesën e fëmijëve të vëllait të saj Xh.Ç. për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të saj, me vendimin nr. 2276, datë 07.11.2011, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka lëshuar këtë dëshmi, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së tretë për trashëgimlënësen M.Ç.(P.), fëmijët e vëllait të saj Xh.Ç. Këta të fundit, në vijim, kanë regjistruar në emër të tyre pasurinë, pjesën përkatëse të banesës dhe të oborrit që figuronte në emër të së ndjerës M.Ç.(P.) dhe më pas, me kontratën noteriale të shitjes së datës 27.04.2012, këtë pasuri ata ua kanë shitur sërish shtetasve A.Ç dhe F.Ç, të cilët, në vijim, duke konsideruar se janë bërë pronarë të ligjshëm tashmë të të gjithë banesës dhe të oborrit të saj, kanë marrë leje ndërtimi për rikonstruksionin e saj, përveçse e kanë vendosur pasurinë edhe si garanci hipotekare për marrje kredie bankare.

7. Nga ana tjetër, sipas një testamenti noterial të datës 03.12.1993, shtetasja M.Ç.(P.) ka disponuar pasurinë e saj pas vdekjes në favor të shtetasit P.P., pra nipit të bashkëshortit të saj, për kërkesën e të cilit, me vendimin nr. 1056, datë 25.04.2012, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë testamentare për testatoren M.Ç.(P.), duke përcaktuar shtetasin P.P. si trashëgimtar të vetëm testamentar për të gjithë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj, sikundër edhe për detyrimet që rrjedhin nga trashëgimia. Bazuar në dëshminë e trashëgimisë testamentare shtetasi P.P. ka kërkuar regjistrimin në emër të tij të pasurisë që figuronte në emër të së ndjerës M.Ç.(P.), gjë e cila është refuzuar nga ZRPP-ja, Elbasan për shkak se pasuria e së ndjerës ishte regjistruar tashmë sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore, të lëshuar me vendimin nr. 2276, datë 07.11.2011 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

8. Ndërkohë, ndërsa shtetasi P.P. vijonte të mbante pasurinë tashmë me pretendimin e qenies trashëgimtar testamentar i pronares M.Ç.(P.), kërkuesi, në cilësinë e një prej trashëgimtarëve ligjorë të së ndjerës, ka ngritur padi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit dhe detyrimin e shtetasit P.P. për të njohur si trashëgimtarë të M.Ç.(P.) të gjithë personat, fëmijët e vëllait të saj Xh.Ç., të përcaktuar në vendimin gjyqësor për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të saj. Ai ka pretenduar se testamenti ishte absolutisht i

pavlefshëm në kuptim të nenit 406 të Kodit Civil (KC), për shkak se ishte në kundërshtim me nenin 377 të tij, në kushtet kur testatorja ka disponuar pasurinë jashtë rrethit të personave të përcaktuar në këtë dispozitë, ndonëse ka lënë pas fëmijët e vëllait të saj Xh.Ç.

9. Me vendimin nr. 888, datë 06.07.2015, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka vendosur detyrimin e të paditurit P.P. të njohë kërkuesin me pjesëtarë (të cilësuar sipas vendimit të saj nr. 2276, datë 07.11.2011), si të vetmit trashëgimtarë ligjorë të së ndjerës M.Ç.(P.), si dhe detyrimin e të paditurit për t'i njohur ata trashëgimtarë të së ndjerës për pasurinë banesë dhe të oborrit të saj (pjesës përkatëse). Ndër të tjera, ajo gjykatë ka arsyetuar se nga interpretimi harmonik i neneve 360, 361, 362, 363, 364, 374 dhe 377 të KC-së, arrihet në përfundimin se mund të përfitojnë nga trashëgimia me testament fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshorti, prindërit, personat e paaftë për punë, vëllezërit dhe motrat, gjyshi, gjyshja, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe motrave të paravdekur, pra trashëgimtarët ligjorë të tre radhëve të para, dhe kur këta mungojnë, pasuria mund t'u lihet trashëgimtarëve ligjorë të radhëve të tjera dhe çdo personi tjetër fizik ose juridik edhe jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë. Në rastin konkret, testatorja e M.Ç.(P.) ka cenuar kufizimin ligjor të lirisë së disponimit me testament për sa kohë që ka caktuar si trashëgimtar testamentar nipin e burrit të saj, të paditurin P.P., i cili nuk përfshihet në rrethin e atyre trashëgimtarëve ligjorë të cilëve mund t'u lihet pasuria trashëgimore, si me testament, ashtu edhe me trashëgimi ligjore sipas radhëve, përveçse, për më tepër, testatorja në kohën e vdekjes së saj ka lënë pas fëmijët e vëllait të paravdekur, një ndër të cilët edhe paditësi (kërkuesi). Për rrjedhojë, disponimi me testament në rrethana të tilla bie në kundërshtim me nenin 377 të KC-së, duke qenë testamenti absolutisht i pavlefshëm sipas nenit 406 të këtij kodi. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim i padituri P.P.

10. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2016-1636 (698), datë 18.07.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Kjo gjykatë ka vlerësuar se rrethi i personave që gëzojnë mbrojtje nga neni 377 i KC-së është i përcaktuar në mënyrë shteruese dhe çdo interpretim i zgjeruar dhe i përzier i normave është i gabuar, si dhe në tejkalim të ligjit. Sipas saj, në rastin konkret, paditësi (kërkuesi) me pjesëtarë nuk përfshihen në rrethin e personave të përmendur në nenin 377 të KC-së, ndaj ata nuk mund të gëzojnë mbrojtje juridike nga kjo dispozitë, duke bërë që testamenti i testatores M.Ç.(P.), përballë pretendimit të paditësit, të jetë i vlefshëm dhe në përputhje me dispozitat urdhëruese të ligjit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe kërkuesi.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2025-609, datë 12.02.2025, ka vendosur mospranimin edhe të rekursit të kërkuarit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Ai kolegji ka vlerësuar se nga ana e gjykatës së apelit janë respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit, ndërkohë që nuk rezultonte të kishte shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimeve, përveçse nga ajo gjykatë janë respektuar drejt dispozitat e ligjit material dhe vendimi i saj nuk bie në kundërshtim me praktikën e atij kolegji ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

12. Në datën 04.06.2025 kërkuar ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), përmes të cilit ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Lartë të dhënë në procesin gjyqësor në lidhje me mosmarrëveshjen e trashëgimisë.

II

Pretendimet e kërkuarit

13. **Kërkuar**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

13.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

13.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs dhe në parashtrimet shtesë të paraqitura me memon e datës 17.12.2024, për faktet e konstatuara pas paraqitjes së rekursit, për më tepër kur gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrim diametralisht të kundërt për interpretimin e nenit 377 të KC-së. Ajo gjykatë nuk ka shqyrtuar dhe nuk ka analizuar pretendimin për rezervën ligjore sipas neneve 371 dhe 379 të KC-së. Për shkak të natyrës së pretendimeve Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në themel.

13.1.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, për shkak se Gjykata e Lartë ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme shkaqet e rekursit, edhe pse ishin nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, siç është pretendimi se vendimi i gjykatës së apelit bie në kundërshtim me praktikën e asaj gjykate, e konstatuar edhe në relacionin e këshilltares ligjore. Çështja e kërkuarit nuk është shqyrtuar sipas rendit kronologjik, sipas datës së regjistrimit, duke u shqyrtuar më parë se

çështja nr. 11243-01205-00-2016, datë 14.04.2016, mes të njëjtave palë ndërgjyqëse, në të cilën gjykata e apelit ka vlerësuar se vendimi për lëshimin e dëshmisë testamentare nuk ka efekt ndaj të tretëve që nuk kanë qenë në proces dhe as ka fuqi provuese për vërtetimin e së drejtës së trashëgimisë testamentare, qëndrim ky diametralisht i kundërt me atë të mbajtur në rastin konkret për trashëgiminë e së ndjerës M.Ç.(P.). Po kështu, në përbërjen e trupit gjykues ka qenë gjyqtari E.Dh., i cili ka qenë më parë pjesë e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. 00-2023-2047, datë 24.05.2023, për mospranimin e rekursit të P.P. për trashëgiminë e M.Ç.(P.). Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar me vonesë kërkesën e datës 17.02.2025 për përjashtimin e të njëjtit trup gjykues të caktuar edhe për shqyrtimin e çështjes nr. 11243-01205-00-2016, datë 14.04.2016, ndërkohë që edhe procedura e dorëheqjes së atyre gjyqtarëve ka zgjatur shumë. Nga ana tjetër, në pikën 27 të vendimit objekt ankimi, kërkuesi është pasqyruar jo si paditës, por si i paditur, sikundër në pikën 26 të vendimit, shtetasit A.Ç. dhe F.Ç. janë pasqyruar si të paditur, ndërkohë që kanë cilësinë e personave të tretë.

- 13.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është i qartë dhe në analizë të plotë të rrethanave faktike e ligjore dhe pretendimeve të palëve, të meta që nuk e bëjnë logjik përfundimin e arritur. Në vendim nuk është pasqyruar dhe arsyetuar për vendimin e datës 30.03.2016 të përmbaruesit gjyqësor privat për pushimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit, në zbatim të vendimit nr. 1368, datë 21.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, si dhe për shkresën e datës 11.03.2016, që provojnë shlyerjen e detyrimit trashëgimor monetar të M.Ç.(P.) nga trashëgimtarët ligjorë në favor të të paditurit P.P., duke fituar ata juridikisht të drejtën e trashëgimisë për të gjitha pasuritë e së trashëgimlënësës. Ajo gjykatë nuk ka bërë interpretimin përfundimtar të dispozitave për trashëgiminë edhe pse në prani të vendimmarrjeve diametralisht të kundërta të gjykatave më të ulëta. Nga njëra anë, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit dhe, nga ana tjetër, ka arsyetuar se gjykata e apelit ka respektuar dispozitat e ligjit material, duke shqyrtuar indirekt themelin e çështjes, por pa bërë asnjë analizë për të. Ajo gjykatë nuk ka arsyetuar për procedurën e paligjshme të ndjekur nga gjykata e apelit, e cila ka ndryshuar vendimin e

gjykatës së shkallës së parë, duke e rrëzuar padinë, ndonëse i padituri P.P. në ankim ka kërkuar pushimin e çështjes dhe vetëm gjatë gjykimit ka kërkuar rrëzimin e padisë. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim as për pretendimin se gjykata e apelit ka zgjidhur mosmarrëveshjen pa thirrur dhe pa dëgjuar të gjithë trashëgimtarët ligjorë të së ndjerës M.Ç.(P.), duke mos mbajtur parasysh të drejtat e fituara me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 766, datë 28.03.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, që i përket procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga P.P. për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore ku në cilësinë e palës së paditur ka qenë edhe F.M.(Ç.), vendim nga i cili ajo tërheq të drejta në cilësinë e trashëgimtares ligjore. Kjo përbën cenim edhe të *parimit të sigurimit të sigurisë juridike në aspektin e “gjësë së gjykuar”*, pasi pozita juridike e shtetases F.M.(Ç.) (motra e ndjerë e kërkuarit) si trashëgimtare ligjore e trashëgimlënëses M.Ç.(P.) nuk mund të prekej pa iu garantuar e drejta për të qenë e pranishme në procesin gjyqësor.

- 13.2. *Parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit*, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, për shkak se Gjykata e Lartë ka favorizuar të paditurin P.P. duke diskriminuar kërkuarësin dhe personat e tretë A.Ç. dhe F.Ç., pasi nuk ka evidentuar dhe nuk ka trajtuar pretendimet e ngritura nga ata. Ajo nuk është shprehur për pretendimet e memos së datës 17.12.2024 të kërkuarit, që ka të bëjë me faktet e konstatuara pas paraqitjes së rekursit, konkretisht: faktin penal të konstatuar nga Prokuroria e Elbasanit për përdorimin e një certifikate familjare të falsifikuar nga i padituri P.P.; dënimin e tij për veprën penale të kallëzimit të rremë me vendimin gjyqësor të formës; faktin e shlyerjes nga trashëgimtarët ligjorë të M.Ç.(P.) të detyrimit monetar ndaj të paditurit P.P., referuar vendimit të përmbaruesit gjyqësor të datës 30.03.2016, për pushimin e ekzekutimit, si dhe për faktin e moskundërshtimit nga i padituri të qenies trashëgimtarë ligjorë të së ndjerës M.Ç.(P.) të fëmijëve të vëllait të saj në procesin gjyqësor që i përket vendimit të formës së prerë nr. 766, datë 28.03.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë as objektin dhe përmbajtjen e shkresës së datës 10.02.2025 të personave të tretë A.Ç. dhe F.Ç., as praktikën e ndryshme të kolegjeve të saj për interpretimin e nenit 377 të KC-së në të njëjtën mënyrë si gjykata e shkallës së parë. Trashëgimtarët ligjorë të

M.Ç.(P.) janë diskriminuar edhe për shkak se i njëjti trup gjykues ka vendosur të gjykojë më pas çështjen nr. 11243-01205-00-2016, datë 14.04.2016, me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, në të cilin ata janë palë në gjykim.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

14. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, lidhur me legjitimimin *ratione personae*, Kolegji thekson se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, kërkuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kuptim, në aspektin procedural kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e procesit gjyqësor në të cilin ai ka qenë palë ndërgjyqëse. Për sa i përket aspektit substancial, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka ngritur pretendime edhe për cenimin e të drejtave të personave të tretë në procesin gjyqësor, shtetasve A.Ç. dhe F.Ç., sikundër edhe për ato të të paditurit P.P., të cilat nuk lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë të të drejtave të tij kushtetuese, duke mos provuar kështu ai interesin e ligjshëm vetjak për mbrojtjen e tyre. Për rrjedhojë, për këto pretendime kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*.

16. Për sa i përket shterimit të mjeteve juridike efektive, neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, përcakton se Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo

vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 56, datë 21.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual në drejtim të së drejtës së aksesit, kërkuuesi ka pretenduar se edhe Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimin e tij për cenimin e rezervës ligjore sipas neneve 371 dhe 379 të KC-së. Kolegji vëren se edhe pse ky pretendim është një prej shkaqeve të rekursit, pra është ngritur formalisht përpara Gjykatës së Lartë, referuar vendimeve të gjykatave të faktit, rezulton se baza dhe shkaku ligjor i padisë së kërkuessit si paditës ka qenë pavlefshmëria e testamentit për shkak se testatori ka disponuar në kundërshtim me nenet 374 dhe 377 të KC-së. Për rrjedhojë, referuar këtij shkaku ligjor të padisë, hetimi gjyqësor dhe argumentet e gjykatave janë fokusuar në pavlefshmërinë e testamentit për rrethin e personave të cilët janë të zotë për të trashëguar me testament. Në këto kushte, për sa kohë që pretendimi i kërkuessit lidhur me nenet 371 dhe 379 të KC-së përbën, në thelb, një shkak të ri, që ka kapërcyer shkaku mbi të cilin është vënë në lëvizje procesi gjyqësor dhe që është shqyrtuar nga gjykatat e zakonshme, ai nuk mund të kërkojë mbrojtje ligjore në këtë drejtim pa shteruar më parë mjetet juridike në dispozicion, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Për rrjedhojë, ngritja e një pretendimi të tillë formalisht përpara Gjykatës së Lartë nuk mund të rivendosë kërkuessin në të drejtat e tij procedurale dhe as nuk mund t'i sigurojë atij mbrojtje kushtetuese në këtë gjykatë.

18. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji vlerëson se kërkuuesi i ka parashtruar në formë dhe në substancë përpara gjykatave të zakonshme, ndaj nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

19. Kërkuuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 12.02.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 04.06.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, në ankimin kushtetues individual kërkuuesi ka pretenduar cenimin e: (1) së drejtës së aksesit; (2) së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme; (3) standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor; (4) parimit të barazisë përpara ligjit pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

21. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë paanshme, për shkak se: i) Kolegji Civil ka vlerësuar në mënyrë të njëanshme se rekursi nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së, në kundërshtim me sa ka vlerësuar ka vlerësuar këshilltarja ligjore; ii) çështja nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë në bazë të rendit kronologjik, sipas datës së regjistrimit në raport me një çështje tjetër të tij të regjistruar më parë; iii) gjyqtari E.Dh. i Gjykatës së Lartë ka qenë njëkohësisht pjesë e trupit gjykues që ka vendosur mospranimin e rekursit të P.P. në një çështje për trashëgiminë e M.Ç.(P.); iv) kërkesa për përjashtimin e të njëjtit trup gjykues nga çështja tjetër e tij është shqyrtuar me shumë vonesë, përveçse edhe procedura e dorëheqjes së gjyqtarëve ka zgjatur shumë; v) në pikën 27 të vendimit të saj e ka pasqyruar kërkuesin jo si paditës, por si të paditur.

22. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. E drejta për një gjykatë të paanshme nënkupton mungesën e paragjytimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar, si dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; 23, datë 04.11.2008, nr. 11, datë 02.04.2008; nr. të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në dy vendimet e dhëna për rrethana të ndryshme të çështjes, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme (*shih vendimet nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 22, datë 20.05.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa i përket shkakut të parë për qëndrimin e ndryshëm të Gjykatës së Lartë nga ai i këshilltares së çështjes, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se veprimtaria që ushtron këshilltari ligjor ka karakter këshillues dhe ndihmës, në ndryshim nga ajo e gjyqtarit, që ka karakter vendimmarrës. Rregullat procedurale që normojnë veprimtarinë e Gjykatës së Lartë kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rolin dhe pozicionin, si dhe kompetencat e këshilltarit ligjor gjatë procesit të vendimmarrjes (*shih vendimet nr. 49, datë 05.10.2023; nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, kur pretendimet e ngritura kanë të bëjnë me

mospërputhje në linjë dhe në arsyetim ndaj akteve të brendshme me natyrë përgatitore dhe ndihmuese dhe vendimeve përfundimtare, kontrolli kushtetues ushtrohet vetëm ndaj këtyre të fundit (*shih vendimin nr. 4, datë 31.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit në këtë drejtim nuk i përket natyrës kushtetuese, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Në lidhje me shkakun e dytë të pretenduar nga kërkuari, atë se çështja nuk është gjykuar sipas rendit kronologjik, sipas datës së regjistrimit në raport me një çështje tjetër të tij të regjistruar më parë, Kolegji vëren se kërkuari nuk ka arritur të argumentojë në këndvështrimin kushtetues cenimin e parimit të paanshmërisë, për këtë shkak. Për më tepër, në vlerësimin e Kolegjit, çështjet gjyqësore të cilave u referohet kërkuari u janë ngarkuar si relatorë dy gjyqtarëve të ndryshëm dhe secili prej tyre ka detyrimin të respektojë kalendarin e shqyrtimit të çështjeve për të cilat është ngarkuar, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes. Në këtë kuptim, krahasimi mes kalendarëve të gjykimit të gjyqtarëve të ndryshëm nuk përbën argument kushtetues në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, për rrjedhojë edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Sipas kërkuarit, e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme i është cenuar edhe për shkak të pjesëmarrjes në trupin gjykues të Gjykatës së Lartë të gjyqtarit E.Dh., i cili ka gjykuar edhe një çështje tjetër ku ka qenë palë shtetasi P.P. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se në rastet e mospranimin të rekursit Gjykata e Lartë shqyrton vetëm ekzistencën ose jo të shkaqeve ligjore të parashtruara në të, pa vlerësuar themelin e mosmarrëveshjes midis palëve. Në këtë kuptim, paanshmëria objektive dhe subjektive e gjyqtarëve, të cilët kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, nuk lë shkas për dyshime për njëanshmërinë e tyre gjatë procesit gjyqësor (*shih vendimet nr. 35 datë 25.04.2024; nr. 6, datë 02.03.2018; nr. 7, datë 10.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, rezulton jo vetëm se në të dyja rastet vendimet në fjalë janë marrë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, pa shqyrtuar themelin e çështjes, por edhe se themeli i tyre është i ndryshëm dhe nuk ka asnjë interferencë me tyre, ndërsa çështja tjetër ka pasur për objekt kundërshtimin e veprimeve përmbare nga shtetasi P.P. në lidhje me ekzekutimin e vendimit nr. 1368, datë 21.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për sa i përket masës së detyrimit të llogaritur nga përmbaresi gjyqësor përmes ekspertit. Në këto kushte, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, si rrjedhojë e pjesëmarrjes në trupin gjykues të gjyqtarit E.Dh., janë haptazi të pabazuara.

26. Kërkuesi ka parashtruar si shkak për paanshmërinë e Gjykatës së Lartë edhe se kjo gjykatë ka shqyrtuar me shumë vonesë kërkesën e tij, për përjashtimin e të njëjtit trup gjykues të ngarkuar, edhe për shqyrtimin e çështjes jetër të kërkuarit (nr. 11243-01205-00-2016, datë 14.04.2016), si dhe procedura e dorëheqjes së atyre gjyqtarëve ka zgjatur shumë. Për sa i takon këtij pretendimi, Kolegji vë në dukje se kërkesa për përjashtimin e këtyre gjyqtarëve dhe ajo për dorëheqje nuk është bërë për çështjen në shqyrtim, por për shkak të saj dhe për çështje tjetër, atë me objekt pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, sipas vendimit gjyqësor civil nr. 1368, datë 21.11.2001 të Gjykatës së Rrethit Elbasan. Në këto kushte, për sa kohë që gjyqtarët që kanë dhënë vendimin në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual konkret dhe, për këtë shkak, janë dorëhequr nga gjykimi i çështjes tjetër të kërkuarit, një fakt i tillë, sikundër edhe kohëzgjatja e shqyrtimit të kërkesës së tij për përjashtimin e atyre gjyqtarëve nga çështja tjetër e tij, nuk janë të mjaftueshme në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim paanshmërinë e tyre në rastin konkret, ndaj edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

27. Po në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkuari ka pretenduar se edhe Gjykata e Lartë, në pikën 27 të vendimit të saj, e ka pasqyruar atë jo si paditës, por si të paditur. Për sa i takon gabimit në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Lartë, ku gabimisht në vend të fjalës paditës referohet i paditur, Kolegji vëren se ai përbën një gabim material, i cili, në thelb, nuk e cenon standardin për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme. Në këtë kuptim, për sa kohë që kërkuari nuk ka argumentuar në aspektin kushtetues, në drejtim të të drejtave kushtetuese të shkelura për këtë shkak, Kolegji çmon se edhe ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim.

28. Në ankimin kushtetues individual kërkuari ka pretenduar cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdikriminit*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka trajtuar në mënyrë të barabartë në rrethanat kur: i) nuk ka evidentuar në vendimin e saj objektin e memos së datës 17.12.2024, që kishte të bënte me fakte të konstatuara pas paraqitjes së rekursit dhe konkretisht dënimin e të paditurit P.P. me vendim gjyqësor të formës së prerë; ii) nuk ka evidentuar në vendim se asaj i janë vënë në dispozicion ato praktika të ndryshme të Kolegjit Civil të saj që konsistojnë në të njëjtin interpretim të nenit 377 të KC-së me atë të gjykatës së rrethit, ndryshe nga sa ka evidentuar një fakt të tillë për aktet e paraqitura nga i padituri P.P.

29. Në lidhje me parimin kushtetues të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të

ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore e për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 5, datë 13.02.2024; nr. 70, datë 27.12.2023; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur nga kjo, argumenti i parë i kërkuarit nuk duket se ka të bëjë me parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, por me të drejtën e aksesit, ndaj do të trajtohet në vijim në këtë aspekt. Kurse argumenti i dytë i tij është i pamjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të treguar se ai është trajtuar në një mënyrë të pabarabartë ose diskriminuese në raport me palën e tij kundërshtare. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

30. Në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit, kërkuari ka parashtruar se edhe Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim as për pretendimin se gjykata e apelit ka zgjidhur mosmarrëveshjen pa thirrur dhe pa dëgjuar të gjithë trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësës M.Ç.(P.), përfshirë edhe shtetasen F.M.(Ç.), motra e ndjerë e tij. Sipas tij, në gjykim nuk janë mbajtur parasysht të drejtat e fituara me vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 766, datë 28.03.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, që i përket procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga P.P. për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, ku në cilësinë e palës së paditur ka qenë edhe F.M.(Ç.), vendim nga i cili ajo tërheq të drejta në cilësinë e trashëgimtares ligjore, ndaj pozita e saj nuk mund të prekej pa iu garantuar e drejta për të qenë e pranishme në procesin gjyqësor.

31. Kolegji, bazuar në natyrën dhe përmbajtjen e këtij pretendimi vëren se në thelb ai ka të bëjë me ndërgjyqësinë në procesin gjyqësor, e cila nga pikëpamja kushtetuese është e lidhur me parimin e kontradiktoritetit në gjykim, mosrespektimi i të cilit e bën procesin të parregullt dhe joligjor. Në rastin konkret ndërgjyqësia rezulton të jetë formuar sipas vullnetit të vet kërkuarit, si pala që e ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor. Nga ana tjetër, ndonëse nëpërmjet padisë në këtë rast është synuar mbrojtja e së drejtës së trashëgimisë (ligjore) në kuptim të gjerë, në thelb, përmes saj, duke kërkuar pavlefshmërinë e testamentit në favor të palës kundërshtare (të paditurit P.P.), është synuar marrja nga gjykata të një vendimi për vërtetimin e mospasjes ky i fundit të së drejtës së trashëgimisë testamentare nga trashëgimlënësja M.Ç.(P.), çka, për pasojë, do t'i hapte rrugë ose do të konfirmonte zbatimin e trashëgimisë ligjore. Nisur nga kjo, sikurse ligji nuk pengon dhe as vendos kufizime, pra nuk imponon krijimin e ndonjë bashkëndërgjyqësie të detyrueshme (aktive), kërkuari rezulton të ketë zgjedhur të përdorë i vetëm mjetin juridik të padisë dhe, po ashtu, të mos

thërrasë në gjykim edhe ata persona që tërhiqnin të njëjta interesa me të në lidhje me rezultatin e procesit gjyqësor. Në këtë kuptim, mosveprimi i gjykatës në krijimin e një ndërgjyqësie të ndryshme nga ajo e përcaktuar nga paditësi nuk duket që të jetë në mosrespektim të ligjit procedural, përveçse po ashtu ajo nuk është thirrur për të ndërhyrë në krijimin e një ndërgjyqësie të ndryshme ose për plotësimin e saj, për sa kohë personat që tërhiqnin të njëjta interesa me paditësin për rezultatin e procesit gjyqësor, kanë zgjedhur të mos i kërkojnë asaj të marrin pjesë në proces me ndonjë cilësi të caktuar procedurale. Për rrjedhojë, procesi gjyqësor i zhvilluar mbi atë ndërgjyqësi, si në rastin konkret, nuk e bën atë të parregullt dhe joligjor, për sa kohë në proces është respektuar kontradiktoriteti dhe palët që tërhiqnin interesa të kundërta kanë pasur mundësi të debatojnë për faktet dhe ligjin, si dhe të paraqesin prova në mbështetje të pretendimeve të tyre. Për pasojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

32. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuarit në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, konkretisht ato për *cenimin e së drejtës së aksesit dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, të pretenduara si të cenuara nga Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën dhe thelbin e tyre, Kolegji çmon t'i shqyrtojë ato në vijim të lidhura së bashku.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

33. Sipas kërkuarit, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është i qartë dhe në analizë të plotë të rrethanave faktike dhe ligjore duke e bërë atë alogjik, për sa kohë: i) nuk ka bërë një interpretim përfundimtar të dispozitave për trashëgiminë, në kushtet kur vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta kanë qenë diametralisht të kundërta; ii) ka mbajtur qëndrim kontradiktor, pasi, ndërsa ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, ka arsyetuar se në zgjidhjen e çështjes gjykata e apelit ka respektuar dispozitat e ligjit material; iii) nuk ka arsyetuar për paligjshmërinë e vendimit të gjykatës së apelit, e cila ka disponuar me rrëzimin e kërkesë padisë ndërkohë që i padituri në ankim kishte kërkuar pushimin e gjykimit. iv) nuk u ka kthyer përgjigje pretendimeve të ngritura në rekursin e shkurtuar për zënie afati, në rekursin e plotësuar dhe në parashtrimet shtesë të paraqitura me memon nr. 6288 prot., datë 17.12.2024, për vendimin e formës së prerë për dënimin e shtetasit P.P., si dhe për vendimin e datës 30.03.2016 të përmbaruesit gjyqësor privat për pushimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit.

34. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nëse mohohet e drejta e aksesit, procesi konsiderohet i parregullt, sepse ajo, përpara së gjithash, është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 16, datë 23.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Po kështu, Gjykata ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomën e këshillimit është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka mbajtur qëndrimin se nuk është arbitrar interpretimi i ligjit procedural nga Gjykata e Lartë për papranueshmërinë e shtesës së rekursit, sipas të cilit, bazuar në nenin 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit, përveç rasteve kur ligji i jep të drejtën të investohet kryesisht, ndërkohë që në kushtet kur shqyrtimi gjyqësor kufizohet vetëm brenda shkaqeve të parashtruara në rekurs, shkaqet e reja të parashtruara në

shtesën e rekursit nuk mund të merren në vlerësim, pasi për shkak të ligjit janë të papranueshme (shih vendimin nr. 30, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese).

38. Në rastin konkret, Kolegji vëren se, referuar neneve 360-364, 374 dhe 377 të KC-së, gjykata e rrethit ka vënë në dukje se testatorja ka caktuar si trashëgimtar testamentar nipin e burrit të saj, P.P., i cili nuk përfshihej në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të cilëve mund t'u lihej pasuria, përfshirë ata të cilëve u takonte trashëgimia ligjore dhe ajo testamentare. Për më tepër, testatorja kishte lënë pas fëmijët e vëllait të paravdekur, një ndër të cilët ishte edhe kërkuesi, i cili, për shkak të statusit të tij, kishte të drejtën të trashëgonte. Në këtë situatë, sipas asaj gjykate, caktimi i P.P. si trashëgimtar testamentar binte në kundërshtim me nenin 377 të KC-së, duke e bërë testamentin të pavlefshëm, sipas nenit 406 të këtij kodi.

39. Në ndryshim nga gjykata e rrethit, gjykata e apelit ka vlerësuar se neni 377 i KC-së përcaktonte në mënyrë shteruese trashëgimtarët, të cilët kur janë gjallë në kohën e bërjes së testamentit, përbëjnë fakt ndalues në lënien e pasurisë me testament në favor të personave të tjerë jashtë këtij rrethi. Sipas kësaj gjykate, këta persona janë vetëm të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat e testatorit dhe kur nuk ka të tillë të gjallë, liria e disponimit me testament është e pakufizuar për efekt të kësaj dispozite, duke përjashtuar ndonjë shkak pavlefshmërie. Kërkuesi ishte një ndër fëmijët e vëllait të paravdekur të Xh.Ç. dhe asnjëri prej tyre nuk përfshihej në rrethin e personave që përcaktonte neni 377 i KC-së, ndaj nuk mund të gëzonte mbrojtje juridike nga kjo dispozitë, duke bërë që testamenti i testatores të ishte i vlefshëm dhe në përputhje me dispozitat urdhëruese të ligjit. Po sipas gjykatës së apelit, në gjykim, nuk ishin provuar, por as pretenduar shkaqe të tjera që çonin në pavlefshmërinë e testamentit, në formë ose përmbajtje dhe kërkuesi nuk provonte tjetër lloj interesi të ligjshëm që do të bënte të cënueshëm testamentin, pasi nuk ishte as trashëgimtar rezervatar dhe as kishte pretendime si i tillë.

40. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë për shqyrtim shkaqet ligjore për rekurs dhe memon e kërkuesit me nr. 688 prot., datë 17.12.2024, të cilat gjenden të pasqyruara në vendimin objekt të ankimit kushtetues ka theksuar se, referuar nenit 473/a të KPC-së, ajo e shqyrton çështjen brenda kufijve të rekursit dhe se, tej kësaj, palët ndërgjyqëse mund të paraqesin shpjegime për shkaqet e parashtruara në rekurs, por nuk mund të ngrenë shkaqe të reja dhe aq më pak të paraqesin prova të reja. Në lidhje me thelbin e çështjes, kjo gjykatë e ka vlerësuar të drejtë, në thelb, qëndrimin e gjykatës së apelit, si për sa i përket cilësimit të fakteve e rrethanave të mosmarrëveshjes dhe analizës juridike të provave, ashtu edhe interpretimit të dispozitave

përkatëse të KC-së për trashëgiminë, si edhe disponimin e asaj gjykate (gjykatës së apelit) në lidhje me çështjen.

41. Në këndvështrim të sa më sipër, në analizë të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se, edhe pse me një arsyetim të kufizuar, pasi ka pasqyruar pretendimet e ngritura nga kërkuesi në rekurs dhe në memon e datës 17.12.2024, ka vlerësuar se pretendimet e ngritura nga ai në memon për dënimin e të paditurit P.P., si dhe për vendimin e datës 30.03.2016 të përmbaruesit gjyqësor privat, nuk mund të merren në shqyrtim nga ajo, për sa kohë shqyrtimi i saj bazohet në shkaqet e paraqitura në rekurs, si dhe se, si gjykatë e ligjit, nuk mund të bëjë vlerësim të provave, të cilat nuk i janë nënshtruar më parë vlerësimit nga gjykatat e faktit. Ndërsa për themelin e çështjes, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs nuk gjenin mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, pra se nuk kishte në substancë shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

42. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Lartë tregon vendimmarrjen e gjykatave të faktit, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Gjykata e Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në nenin 472 të KPC-së. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për pretendimet e tij në përputhje me parashikimet ligjore dhe interpretimi i saj nuk rezulton kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm ose me kundërthënie. Ndërkohë që vetëm fakti se ajo ka vendosur mospranimin e rekursit nuk është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim respektimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit, si aspekte të së drejtës për proces të rregullt. Prandaj pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë haptazi të pabazuara.

43. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “b”, “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.